

Interpretimi i KIRFN 7

Zbatimi i Metodës së Riparaqitjes sipas SNK 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste

Referencat

- SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*
- SNK 29 *Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste*

Informacion Bazë

- 1 Ky interpretim jep udhëzime për mënyrën si duhet të zbatohen kërkesat e SNK 29 në një periudhë raportuese në të cilën një njësi ekonomike identifikon¹ ekzistencën e hiperinflacionit në ekonominë e monedhës së saj funksionale, kur kjo ekonomi nuk ishte hiperinflacioniste në periudhën e mëparshme, dhe njësi ekonomike si pasojë riparaqet pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNK 29.

Çështjet

- 2 Pyetjet që adresohen në këtë interpretim janë:
 - (a) Në ç`mënyrë duhet të interpretohet kërkesa ‘...shprehur në termat e njësisë matëse aktuale në datën e bilancit’ në paragrafin 8 të SNK 29, kur një njësi ekonomike aplikon Standardin?
 - (b) Si duhet të përcaktojë një njësi ekonomike zërat e tatimeve të shtyra në çelje në pasqyrat e saj financiare të riparaqitura?

Konsensusi

- 3 Në periudhën raportuese në të cilën një njësi ekonomike identifikon ekzistencën e hiperinflacionit në ekonominë e monedhës së saj funksionale, duke mos qenë hiperinflacioniste në periudhën e mëparshme, ajo do të zbatojë kërkesat e SNK 29 sikur ekonomia të kishte qenë gjithnjë hiperinflacioniste. Prandaj, në lidhje me zërat jo-monetarë të matur me kostot historike, bilanci i çeljes të njësisë ekonomike në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur në pasqyrat financiare do të riparaqitet, për të pasqyruar efektin e inflacionit nga data e blerjes së aktiveve dhe data kur detyrimet janë shkaktuar apo pranuar, deri në datën e mbylljes së bilancit të periudhës raportuese. Për treguesit jomonetarë të mbajtur në bilancin e çeljes me shumat aktuale në datat që ndryshojnë nga data e blerjes dhe ndodhjes, kjo riparaqitje do të tregojë më mirë efektin e inflacionit që nga datat kur këto shuma të mbartura u përcaktuan deri në datën e mbylljes së bilancit të periudhës raportuese.
- 4 Në datën e mbylljes së bilancit, zërat e tatimeve të shtyra maten dhe njihen në përputhje me SNK 12. Megjithatë, shifrat e tatimeve të shtyra në bilancin e çeljes për periudhën raportuese do të përcaktohen si më poshtë:

¹ Identifikimi i hiperinflacionit bazohet në gjykimin që u bën njësi ekonomike kritereve në paragrafin 3 të SNK 29

- (a) njësia ekonomike rimat zërat e tatimeve të shtyra në përputhje me SNK 12 pasi ajo ka riparaqitur vlerat kontabël (neto) nominale të zërave të saj jo-monetarë në datën e çeljes së bilancit të periudhës raportuese duke zbatuar njësinë matëse në këtë datë.
- (b) zërat e tatimeve të shtyra të rimatura në pajtim me (a) janë riparaqitur për ndryshimin në njësinë matëse nga data e çeljes së bilancit të periudhës raportuese deri në datën e mbylljes së bilancit të kësaj periudhe.

Njësia ekonomike zbaton metodën (a) dhe (b) në riparaqitjen e zërave të tatimeve të shtyra në bilancin e çeljes të cdo periudhe krahasuese të paraqitur në pasqyrat financiare të riparaqitura për periudhën raportuese në të cilën njësia zbaton SNK 29.

- 5 Pasi një njësi ekonomike ka riparaqitur pasqyrat e saj financiare, të gjitha shifrat koresponduese në pasqyrat financiare për një periudhë raportuese të mëpasshme, përfshirë zërat e tatimeve të shtyra, ripasqyrohen duke zbatuar ndryshimin në njësinë matëse për këtë periudhë raportuese pasuese, vetëm për pasqyrat financiare të riparaqitura për periudhën raportuese parardhëse.

Data e hyrjes në fuqi

- 6 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë me datën 1 Mars 2006 ose pas kësaj date. Inkurajohet fillimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për një periudhë që fillon para datës 1 Mars 2006, ajo do të duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.